



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 22 (827774)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 3 Qershor 2022

Ministri Peleshi: Ambicia jonë, investime të mëdha në fushën e infrastrukturës, të gatshëm për "Defender 2023"

Për dy ditë më radhë, efektivë të Forcës Detare në Forcat e Armatosura zhvilluan në bregdetin e vendit stërvitjen "GrupEx - 22". Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i pranishëm në nisje të kësaj stërvitjeje, e cilësoi të rëndësishme atë, veçanërisht në këtë moment të rritjes së standardeve të Forcave të Armatosura.

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi foli për një plan ambicioz që Ministria e Mbrojtjes dhe qeveria ka për Sig-

urinë Kibernetike: "Për Forcën Detare kemi gjithashtu ambicie dhe plane ashtu siç i kemi ndarë me komandantin për të shtuar flotën tonë në një të ardhme afatmesme, për të rritur kapacitetet tona të mirëmbajtjes. Jemi në proces të identifikimit në mënyrat më të mira se si mund të kemi një përgjigje më të mirë të të gjitha nevojave për mirëmbajtje, por edhe siç e thashë, të ndërtimit, blerjes së anijeve të tjera siç i kemi në objektivat

e kapaciteteve", - u shpreh ministri i Mbrojtjes. Z. Peleshi u shpreh se parashikohen investime të mëdha në fushën e infrastrukturës dhe këto po diskutohen dhe planifikohen edhe me programin qeveritar si pjesë e projekteve të mëdha për Shqipërinë. Ministri i Mbrojtjes vuri në dukje përvojën që Forcat e Armatosura të Shqipërisë morën pikërisht një vit më parë nga stërvitja më e madhe "Defender 2021".... » faqe 2



MINISTRI I MBROJTJES, INTERPELANCE PER PRONAT E FA-SË

Ministri Peleshi: Çështja e dhënies së pronave në përdorim të investitorëve nuk është mëkat, por detyrë që na e cakton ligji



Gjeneralmajor Bajram Begaj priti në takim drejtorin e Përgjithshëm të Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguesit

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral-major prof. asoc. Barjam Begaj, priti në një takim kortezie Ambasadorin Stephen Beecroft, drejtor i Përgjithshëm i Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguesit (MFO - Multinational Force and Observers). Në fjalën e tij në takim, gjeneralmajor Begaj i uroi z. Beecroft mirëseardhjen në Shtabin e Përgjithshëm të FARSH dhe vlerësoi rolin e kësaj strukture, si një organizatë paqeruajtëse...



» faqe 3

In memoriam/ Ndahet nga jeta ish-presidenti Bujar Nishani

Ndahet nga jeta ish-komandanti i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë Bujar Nishani. Me një karrierë të gjerë në FASH, arriti deri në postin e presidentit të vendit. Cili ishte formimi i tij akademik? Studimet e larta, Bujar Nishani i kreu në Akademinë Ushtarake "Skënderbej" në Tiranë, në vitin 1988. Ka kryer studimet pasuniversitare në Kaliforni, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për "Menaxhimin e Resurseve të Mbrojtjes", në vitin 1996. Studioi për Jurisprudencë në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, ku u diplomua si jurist në...



» faqe 4

Asllan Zemani, studiues i historisë ushtarake dhe veprimtar shoqëror

Dashuri për njerëzit dhe fshatin Kuç U mblodhëm në Kuç në 65-vjetorin e lindjes së Dr. Asllan Zemanit, për të bërë gëzuar me përgjegjësin e muzeut të FA-së. Ishte një dëshirë e stafit të muzeut, për të parë krahinën e Labërisë, rugën e lumit të Vlorës, por dhe Kuçin heroik dhe të martirizuar që në shekuj ka bërë histori dhe ka lënë gjurmë në kujtesën kombëtare. Është një gjë fisnike që Dr. Asllan Zemani e ka marrë nga prindërit e tij, dashurinë për fshatin dhe njerëzit e tij, pavarësisht se nuk ka lindur aty, por në Tiranë, ku dhe prindërit ishin me punë. Si bir i Kuçit të Kurveleshit, i njohur për atdhetarizëm...



» faqe 14

Zhvillohet stërvitja detare "GrupEx - 22"

Ministri Peleshi: Ambicia jonë, investime të mëdha në fushën e infrastrukturës, të gatshëm për "Defender 2023"

Për dy ditë më radhë, efektivë të Forcës Detare në Forcat e Armatosura zhvilluan në bregdetin e vendit stërvitjen "GrupEx - 22". Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i pranishëm në nisje të kësaj stërvitjeje, e cilësoi të rëndësishme atë, veçanërisht në këtë moment të rritjes së standardeve të Forcave të Armatosura.

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi foli për një plan ambicioz që Ministria e Mbrojtjes dhe qeveria ka për Sigurinë Kibernetike: "Për Forcën Detare kemi gjithashtu ambicie dhe plane ashtu siç i kemi ndarë me komandantin për të shtuar flotën tonë në një të ardhme afatmesme, për të rritur kapacitetet tona të mirëmbajtjes. Jemi në proces të identifikimit në mënyrat më të mira se si mund të kemi një përgjigje më të mirë të të gjitha nevojave për mirëmbajtje, por edhe siç e thashë, të ndërtimit, blerjes së anijeve të tjera siç i kemi në objektivat e kapaciteteve", - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Z. Peleshi u shpreh se parashikohen investime të mëdha në fushën e infrastrukturës dhe këto po diskutohen dhe planifikohen edhe me programin qeveritar si pjesë e projekteve të mëdha për Shqipërinë.

Ministri i Mbrojtjes vuri në dukje përvojën që Forcat e Armatosura të Shqipërisë morën



MINISTRI I MBROJTJES NIKO PELESHI

"Vlen të kujtoj që para një viti, në të gjithë territorin e Shqipërisë është zhvilluar stërvitja "Defender-21"; një komponent i rëndësishëm i saj ka qenë edhe në det dhe besoj që kemi marrë mësim, kemi rritur ndërveprueshmërinë në një përmasë që kurrë më parë nuk e kemi pasur shansin. Kështu që jemi tani edhe më gati për t'u bërë një vend pritës, jo vetëm në tokë, por edhe në ajër, edhe në det për vitin tjetër, 'Defender-23' edhe në vazhdim", - theksoi ministri Peleshi.

pikërisht një vit më parë nga stërvitja më e madhe "Defender 2021".

"Vlen të kujtoj që para një viti, në të gjithë territorin e Shqipërisë është zhvilluar stërvitja "Defender-21"; një komponent i rëndësishëm i saj

ka qenë edhe në det dhe besoj që kemi marrë mësim, kemi rritur ndërveprueshmërinë në një përmasë që kurrë më parë nuk e kemi pasur shansin. Kështu që jemi tani edhe më gati për t'u bërë një vend

pritës, jo vetëm në tokë, por edhe në ajër, edhe në det për vitin tjetër, 'Defender-23' edhe në vazhdim", - theksoi ministri Peleshi.

Ndërsa komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand

Agastra shpjegoi qëllimet e kësaj stërvitjeje, që kanë të bëjnë edhe me shërbimin konkret ndaj komunitetit. "Pas kësaj stërvitjeje, anijet do të shpërndahen në të gjithë bregdetin shqiptar; nga Shëngjini deri në Sarandë, në të gjitha portet e hapura, por edhe bazat e Forcës Detare me qëllim që t'i përgjigjemi situatave të sezonit për shkak të rritjes së fluksit të turistëve, të përdorimit edhe të paligjshëm të detit. Anijet do të jenë me kohë në rajon për t'iu përgjigjur të gjitha situatave", - u shpreh kundëradmiral Agastra.

Kjo stërvitje kishte si synim vlerësimin dhe certifikimin e grupeve të anijeve patrulluese si njësi zbatuese, testimin e aftësive organizative dhe komanduese të komandantëve të grupeve, planëzimin e Shtabit të Flotiljes Detare si dhe kryerjen e qitjeve me armatimin e anijeve.

Në stërvitjen "GrupEx-22" dhe qitjet bregdetare morën pjesë 11 anije të Flotiljes Detare, 3 anije të klasit "Archangel" si edhe Grupi i Bordingut. Stërvitja dhe qitjet bregdetare u zhvilluan në përputhje me dokumentet stërvitore si dhe ato të NATO-s.

Komiteti Drejtues i Qendrës së Ekselencës së NATO-s për Ndihmën e Forcave të Sigurisë mbledhet në Shqipëri

Për herë të parë Komiteti Drejtues i Qendrës së Ekselencës së NATO-s për Ndihmën e Forcave të Sigurisë mbledhet jashtë vendit pritës, Italisë. Anëtarët e komitetit të kësaj qendre ekselence u takuan në Golem, Durrës, ku diskutuan projektet aktuale të qendrës, prezantimi i draft-programit të punës për vitin 2023 etj.

Kjo qendër është e përbërë nga 3 vende, përkatësisht, Italia si vend pritës si dhe Shqipëria dhe Sllovenia në rolin e vendeve sponsorizuese. Së shpejti, pjesë e kësaj qendre do të bëhet edhe Austria, gjithashtu si vend partner kontribuues.

Takimi u hap nga drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral



brigade Bilbil Bitri, i cili në fjalën e tij, pasi i uroi mirëseardhjen të gjithë pjesëmarrësve, vlerësoi maksimalisht rolin dhe përgjegjësitë e kësaj qendre. Më tej, ai u ndal tek rëndësia e kësaj qendre si dhe inkurajoi stafin e saj të vijojë kryerjen me sukses të detyrave të tyre.

Ndërkohë, në fjalën e tij, përfaqësuesi shqiptar në komitetin drejtues, përgëzoi stafin e qendrës

për punën e tyre, çka ka bërë që kjo qendër relativisht e re, të ketë një energji dhe entuziazëm mbresëlënës, duke bërë të mundur konfirmimin e saj, jo vetëm në kuadër të NATO-s, por edhe në ambiente të tjera, përfshirë atë akademik.

Në rolin e vëzhguesit, morën pjesë atashetë ushtarake të Italisë, Turqisë, Polonisë, Greqisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Republikës Çeke.

MINISTRI I MBROJTJES, INTERPELANCË PËR PRONAT E FA-së

Ministri Peleshi: Çështja e dhënies së pronave në përdorim të investitorëve nuk është mëkat, por detyrë që na e cakton ligji

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i thirrur në një interpelancë në Kuvend nga opozita për pronat e Forcës Detare, deklaroi se pas vitit 2013 janë privatizuar 50% më pak prona të Forcave të Armatosura se sa para këtij viti.

Duke i cilësuar spekulative të gjitha deklaratat e deputetit të PD-së Ferdinand Xhaferri, ministri i Mbrojtjes iu përgjigj interesit për bazën ushtarake të Kuçovës: “Është shumë pozitive për sigurinë tonë kombëtare dhe rajonale sidomos pas agresionit rus në Ukrainë që ka ndryshuar skenën e sigurisë.”

“Sot që e kemi këtë bazë në rajon jemi krenarë, sepse është një arritje e kohës, e kësaj qeverie, e cila ka ditur të punojë me strukturat euroatlantike me NATO-n dhe po e bëjmë realitet. Ne nuk i vendosim mbiemra politikë këtyre zhvillimeve as me një mandat qeverisjeje, por kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare dhe me vjen keq që po spekuloni. FA-të trashëgojnë asete të një ushtrie të para vitit ‘90. Realiteti ka ndryshuar, por nuk është kollaj të ndryshojë me pronat e ushtrisë. Sot që flasim kemi 1372 prona në emër të FA-së. Një pjesë e tyre janë vënë në dispozicion të zhvillimit, sepse nuk janë në mundësitë tona për t’u përhapur në një numër të tillë pronash. Jemi në një kohë tjetër. Jemi pjesë e NATO-s. Na duhet që këtë numër të madh pronash ta vëmë më eficient, jo ta vëmë thjesht në



vëzhgim. Çështja e dhënies së pronave në përdorim të investitorëve nuk është mëkat, por detyrë që na e cakton ligji”.

Në shpjegimin e tij, ministri i Mbrojtjes tha se para 2013 janë privatizuar

prona brenda bazave të FA-së. “Prona e dhënë me qira në 2014 në Urën Vajgurore nuk ka qenë në Planin e Përhapjes së Forcave të Armatosura. Një kompani ka shprehur interesin për ta marrë me

qira. Nuk janë prona që jep ministri apo kryeministri. Në atë tokë nuk ka ndodhi investimi. Komando e Forcës Ajrore ka bërë kontrollin dhe i ka kërkuar Ministrisë së Ekonomisë të prishë kontratën.

Ministria e Ekonomisë e çmon vetë nëse është në kushte të prishjes së kontratës. Sugjerimin e kemi bërë pasi investimi nuk ka filluar”, -sqaroi ministri Peleshi.

Ndërsa, sa i përket Bazës së Shëngjinit, Peleshi tha se atje ka pasur abuzime me pronat: “Një pjesë e territorit të Bazës së Shëngjinit i është regjistruar privatit në 2009. Pesë kallëzime në gjykatë për veprimet e ish-zyrtareve të PD-së, vetëm drejtësia e re reagoi. Kemi çuar në SPAK Bazën e Shëngjinit, i cili ka sekuestruar ndërtimin.

Ndërtimi në Bazën e Shëngjinit me leje të kryetarit të Bashkisë së Lezhës në kohën e PD-së. Dhënia me qira e Gjirit të Limionit është bërë sipas ligjit. Nëpërmjet qiradhënies, Forca Detare do të përfitojë një investim të ri, modern, pa kosto financiare. Baza në Sarandë mbetet brenda Planit të Përhapjes së FA.”

Duke iu përgjigjur akuzave të deputetit të opozitës, ministri Peleshi tha se PD e ka nxjerrë godinën e SHQUP-it nga Plani i Përhapjes së FA-së brenda 24 orëve.

VIZITA

Gjeneralmajor Barjam Begaj priti në takim drejtorin e Përgjithshëm të Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguesit

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor prof. asoc. Barjam Begaj, priti në një takim kortezie Ambasadorin Stephen Beecroft, drejtor i Përgjithshëm i Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguesit (MFO - Multi-national Force and Observers).

Në fjalën e tij në takim, gjeneralmajor Begaj i uroi z. Beecroft mirëseardhjen në Shtabin e Përgjithshëm të FARSH dhe vlerësoi rolin e kësaj strukture, si një organizatë paqeruajtëse ndërkombëtare, e krijuar me marrëveshje midis Egjiptit dhe Izraelit, për të mbikëqyrur zbatimin e dispozitave të sigurisë të Traktatit të Paqes Egjiptian - Izraelit, duke bërë përpjekjet më të mira për të parandaluar çdo shkelje të mundshme.

Gjeneralmajor Begaj shprehu bindjen se: “Ky rrugëtim që po nisim së bashku do të materializohet në mënyrën e duhur, me identifikimin e kapaciteteve dhe burimeve të nevojshme për të kontribuar në MFO”.

Nga ana e tij, z. Beecroft bëri një përshkrim të detyrave dhe për-



pjekjeve që MFO kryen në mbështetje të dispozitave të sigurisë të Traktatit të Paqes Egjiptian - Izraelit. Ai vlerësoi rolin e Shqipërisë në angazhimin e treguar dhe përpjekjet e saj për të konkretizuar kontributin me personel

ushtarak pranë kësaj strukture.

Vizita e z. Beecroft në Shqipëri përfshin edhe një takim me ministrin e Mbrojtjes.

Origjina e MFO-së qëndron në Aneksin I të Traktatit të Paqes të vitit



1979 ndërmjet Egjiptit dhe Izraelit, në të cilin palët morën përsipër t'i kërkonin OKB-së të siguronte një forcë dhe vëzhgues për të mbikëqyrur zbatimin e këtij traktati. Neni II i Aneksit I të Traktatit të Paqes përcakton

katër zona sigurie: tre të vendosura në Sinai në Egjipt dhe një në Izrael përgjatë kufirit ndërkombëtar. Në këtë aneks përcaktohen edhe kufizimet për forcat dhe pajisjet ushtarake brenda secilës zonë.

Garda Mbretërore e Norvegjisë performoi në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”. së bashku me Orkestrën Frymore të Forcave të Armatosura, bandat treguan se marrëdhëniet mes dy vendeve forcohen dita-ditës si dy aleatë të NATO-s. Mirënjohje Norvegjisë për mbështetjen në rrugën e integrimit, projekte të ndryshme dhe ndihmën për rimëkëmbjen e vendit pas tërmetit të 26 Nëntorit. Së bashku për të garantuar paqen e sigurinë!

Të pranishëm ishin ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, ministri i Mbrojtjes të Kosovës, Armend Mehaj, ministria e Shtetit për Marrëdhëniet për Parlamentin, Elisa Spiropali, ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor Bajram Begaj, kryetari i Bashkisë të Tiranës, Erion Veliaj, ushtarakë dhe qytetarë të cilët shijuan muzikën e performuar me profesionalizëm nga instrumentistët e të dyja bandave.

Mirënjohje Norvegjisë për mbështetjen në rrugën e integrimit, projekte të ndryshme dhe ndihmën për rimëkëmbjen e vendit pas tërmetit të 26 Nëntorit. Së bashku për të garantuar paqen e sigurinë”, -u shpreh ministri Peleshi.

Garda Mbretërore e Norvegjisë konsiderohet si një nga rojet mbretërore më të famshme në botë dhe është një nga njësitë më të mëdha në Forcat e Armatosura të Mbretërisë së Norvegjisë.

Garda Mbretërore e Norvegjisë performon në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”

Ministri Peleshi: Mirënjohje Norvegjisë për mbështetjen në rrugën e integrimit, së bashku për të garantuar paqen e sigurinë



FORCA TOKËSORE



Ministri Peleshi: Në shtator b2k certifikohet nga NATO

Grup-batalioni i Këmbëorisë së Lehtë testoi kapacitetet dislokuese si dhe zhvilloi qitje me armë personale dhe kolektive në stërvitjen 72-orëshe “Biza-22”. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi nëpërmjet videos të postuar nga stërvitjet e këtij grup-batalioni, u shpreh se kjo është “provë shumë e mirë e trupave të b2k-së që në muajin shtator pritet të certifikohen nga NATO si strukturë e gatshme për t’u dislokuar kudo dhe kurdo”. Dislokimi apo transportimi i trupave të një batalioni ushtarak dhe mjeteve të saj nga një pikë në një pikë tjetër është thelbësore për një ushtri të NATO-s.

“IN MEMORIAM”

Ndahet nga jeta ish-presidenti Bujar Nishani

Ndahet nga jeta ish-komandanti i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë Bujar Nishani. Me një karrierë të gjerë në FASH, arriti deri në postin e presidentit të vendit.

Cili ishte formimi i tij akademik?

Studimet e larta, Bujar Nishani i kreu në Akademinë Ushtarake “Skënderbej” në Tiranë, në vitin 1988. Ka kryer studimet pasuniversitare në Kaliforni, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për “Menaxhimin e Resurseve të Mbrojtjes”, në vitin 1996. Studioi për Jurisprudencë në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, ku u diplomua si jurist në vitin 2004. Në vitin 2005 merr titullin “Master”, në Studimet Europiane, në Shkollën e Studimeve Europiane, pranë Universitetit të Tiranës. Karrierën profesionale e nisi si pedagog në Akademinë Ushtarake “Skënderbej” në vitin 1988. Më pas, në vitin 1993 punoi në Drejtorinë për Marrëdhëniet me Jashtë në Ministrinë e Mbrojtjes, duke vazhduar në vitin 1994 në Ministrinë e Jashtme në



Drejtorinë e Marrëdhënieve me NATO-n dhe në vitin 1996 në Kabinetin e Ministrisë të Mbrojtjes. Në vitin 1997, ai

kthehet në profesion të lirë si Kryetar i Forumit të Ushtarakëve Euro-Atlantikë. Nga marsi 2007 – shtator 2009 mba-

jti portofolin e Ministrisë të Brendshme; nga shtatori 2009 – prill 2011 kreu detyrën e Ministrisë të Drejtësisë; për t’u

rikthyer përsëri në prill të vitit 2011 si Ministër i Brendshëm, detyrë të cilën e mbajti deri në qershor të vitit 2012, kohë në të cilën Kuvendi i Shqipërisë e zgjodhi në detyrën e Kreut të Shtetit.


Më 11 qershor 2012, Kuvendi e zgjodhi President të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë mandatit të tij, Nishani ishte përqendruar në procesin e integrimit evropian të vendit dhe sfidat globale që prekin Shqipërinë, siç është kriza e imigrantëve ose luftimi i ekstremizmit islamik dhe radikalizmit.

Ai u zgjodh në vitin 2012, i cili përkujtoi 100-vjetorin e krijimit të Shqipërisë së pavarur dhe ishte një festë njëvjeçare.

Gjatë shumicës së vizitave shtetërore jashtë vendit, Nishani ishte orientuar maksimalisht në forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, duke përmendur mbështetjen e saj për pjesëmarrjen e Kosovës në të gjitha aktivitetet multilaterale rajonale dhe ndërkombëtare.

Ngushëllime familjes, miqve, shokëve për humbjen e të dashurit të tyre!



Bashkëpunimi

Anija e Forcës Detare amerikane "USS Jason Dunham", vizitë në Portin e Durrësit

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra priti në një takim kortezie komandantin e anijes amerikane USS Sason Dunham (DDG109), kapiten i rangut të II Michael S. Kisen dhe atasheun ushtarak të Mbrojtjes të SHBA-së në vendin tonë, kapiten i rangut të II David Millner.

Komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnand Agastra, pasi u uroi mirëseardhjen, i falënderoi për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet dy forcave. Gjatë takimit, komandanti i anijes amerikane falënderoi për mikpritjen, koordinimin, sigurinë e anijes dhe personelit gjatë ditëve të qëndrimit në gjirin e Durrësit. Gjithashtu, komandanti i anijes amerikane gjatë vizitave kulturore që bëri në qytetin e Durrësit



dhe Tiranës shprehu konsideratat dhe përshtypjet më pozitive për vendin tonë.

Në përfundim të takimit, kundëradmiral Agastra u shpreh për vijimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe të mirëpritjes së anijeve amerikane edhe në vazhdim në rajon për të realizuar vizita portuale në vendin tonë.

KOMANDANTI I FORCËS DETARE: TRAJNIMI DHE EDUKIMI I OFICERËVE TË FORCËS DETARE NË BRITANINË E MADHE, SHUMË I RËNDËSISHËM

Komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnand Agastra priti në një vizitë kortezie në Komandën e Forcës Detare atasheun ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar nënkolonelin Timothy Wight-Boycott.

Kundëradmiral Agastra pasi i uroi mirëseardhjen, vlerësoi gjithashtu kontributin e tij në rritjen e mëtejshme të nivelit të bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë midis Forcës Detare të Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar.

Nënkolonel Timothy Wight-Boycott falënderoi për mikpritjen dhe vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm në fushën e Mbrojtjes midis dy forcave detare.

Kundëradmiral Adnand Agastra theksoi rëndësinë e trajnimit dhe edukimit të oficerëve të Forcës Detare në Britaninë e Madhe dhe se vlerat e fituara kanë shërbyer në rritjen e profesionalizimit gjatë kryerjes së detyrave në anije.

Gjatë diskutimeve u dakordësua vijimi i bashkëpunimit në edukimin dhe trajnimin e oficerëve si dhe të eksploroheh mundësitë e bashkëpunimit në fushën e zhytjeve detare, operacioneve të ndalimit detar dhe përgatitjes së oficerëve për operacionet e sigurisë detare.

Kundëradmiral Adnand Agastra pret atasheun ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, nënkolonelin Timothy Wight-Boycott





“Personalisht kam ndjekur me kujdes dhe interesim të veçantë të gjithë aktivitetin gjatë procesit të arsimimit dhe trajnimit në këtë kurs, i cili është thelbësor në formimin e instruktorëve e jo vetëm”



Përfundon Kursi i Instruktorit të Nënoficerit në QAPN

Në ambientet e Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, u zhvillua ceremonia e certifikimit të 10 kursantëve, të cilët përfunduan me sukses kursin e Instruktorit të Nënoficerit. Në këtë ceremoni mori pjesë, zëvendëskomandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, nënkolonel Bedri Qoli, si dhe stafi i instruktorëve të qendrës.

Në fjalën e tij përshëndetëse zëvendëskomandanti përshëndeti kursantët, ku ndërkohë u shpreh se: “Personalisht kam ndjekur me kujdes dhe interesim të veçantë të gjithë aktivitetin gjatë procesit të arsimimit dhe trajnimit në këtë kurs, i cili është thelbësor në formimin e instruktorëve e jo vetëm”. Kursi i 16-të i Instruktorit, u zhvillua në QAPN për një periudhë 3-javore

dhe kishte si qëllim aftësimin, me cilësitë e duhura në njohjen e formave didaktike të përgatitjes dhe të prezantimit të materialit mësimor, formën e komandim detyrimit, bashkëbisedimit, ndodhi-ngjarje, instruktim-diskutimit dhe procesin e zhvillimit të diskutimit dhe vlerësimin grupor. Në këtë kurs u certifikuan 10 kursantë, 5 prej tyre efektiv i QAPN -së.



KURSI I LARTË I OFICERIT

Në kuadrin e procesit mësimor të vitit Akademik 2021-2022, Kursi i Lartë i Oficerit zhvilloi vizitë mësimore në Komandën e Komponentit Tokësor të NATO-s në Izmir, Turqi.

Qëllimi i vizitës mësimore ishte njohja e kursantëve të Kursit të Lartë të Oficerit (KLO) me misionin, detyrën, organizimin, strukturat e Komandës së Komponentit Tokësor të NATO-s, si dhe operacionet aktuale që ajo kryen duke u fokusuar tek procesi i planëzimit operacional.

Kursantët dhe stafi pedagogjik u pritën nga zëvendësshefi i Shtabit për Planet (DCOS Plans) në KKT, gjeneral brigade Jose Maria Martinez Ferrer dhe u shoqëruan gjatë gjithë aktivitetit nga përfaqësuesi shqiptar nënkolonel Aleksandër Xhafa.

Në takimin me gjeneral Martinez Ferrer ai u shpreh se vizita të tilla janë tepër të rëndësishme, jo vetëm për kursantët por dhe për vetë KKT, pasi shkëmbimi i mendimeve me kursantët të këtij niveli (me pjesëmarrje nga të gjitha forcat) ndihmojnë dhe komponentin për të nxjerrë konkluzione mbi veprimtarinë në tërësi.

Në këtë takim gjithashtu u mbajtën një sërë prezantimesh mbi strukturën, organizimin dhe detyrat e KKT.

Në fund të fjalës së tij Shefi i Departamentit të Operacioneve kolonel Edmond Sardi, falënderoi gjeneralin për fjalët dhe pritjen e ngrohtë, si dhe në emër të komandantit të Akademisë së Forcave të Armatosura i dorëzoi atij emblemën e AFA-së.

KLO, vizitë mësimore në Komandën e Komponentit Tokësor të NATO-s në Izmir, Turqi



ANJEZA MUSOLLARI,
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE

Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve është tashmë jo vetëm një ditë festive, por edhe në një ditë për t'i thënë jo dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve. Është dita kur vetë fëmijët shprehen lirshëm për të vënë në dukje të drejtat e tyre.

Dita e fëmijëve u vendos në datën 1 qershor, sepse në këtë datë është mbajtur Konferenca Botërore e Mirëqenies së Fëmijëve në Gjenevë, në 1925. Dy vjet më pas Festa e 1 qershorit filloi të festohet në të gjithë botën.

Vendet të cilat e festojnë Ditën Botërore të Fëmijëve, më datën 20 nëntor e bëjnë këtë në përkujtim të Deklaratës për të Drejtat e Fëmijëve miratuar nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, më 20 nëntor të vitit 1959. Në Shqipëri, Kosovë dhe mbarë botën, kjo ditë u kushtohet fëmijëve, me organizime dhe aktivitete të larmishme. Shumë vende të botës e kanë pranuar atë si festën ndërkombëtare të fëmijëve dhe realizojnë festime të cilat kanë si qëllim të rrisin vëmendjen në drejtim të mirëqenies së tyre. “Të gjithë njerëzit janë të lirë dhe të lindur me të drejta dhe dinjitet të barabartë”. Kështu fillon Neni I Deklaratës së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Të gjithë ne, sapo lindim, kemi të drejta të caktuara, të quajtura të drejta të njeriut. Thelbi i të drejtave të njeriut është dinjiteti i njeriut, pastaj e drejta e shprehjes së personalitetit, trajtimit të barabartë dhe barazisë para ligjit, liria e besimit dhe ndërgjegjes, e mendimit, shtypit, informimit dhe e mesimit, liria e mbledhjes dhe e bashkimit, zemërgjerësisë, liria e profesioneve dhe e punës, pacenueshmëria e banesës, garantimi i pasurisë dhe i të drejtës së trashëgimisë, e drejta e strehimit politik dhe e peticionit, si dhe të drejtat juridike, si garanci kundër arrestimit të padrejtë, e drejta për t'u punësuar etj. Të drejtat e njeriut janë në të njëjtën kohë edhe vlera që shprehin dhe pasqyrojnë dëshirat dhe aspiratat njerëzore. Si vlera, të drejtat e njeriut përfaqësojnë qëllimet dhe idealin më të larta, të cilat, ndonëse të pabarazueshme plotësisht, i japin kuptimin jetës shoqërore. Gjatë gjithë historisë, të drejtat e njeriut janë përcaktuar dhe kanë mëshiruar vlerën e dinjitetit të secilit, të lirisë, të barazisë dhe të drejtësisë. Këto vlera janë universale, ato dalin jashtë kornizave të kufijve personalë e kombëtarë. Kulturat dhe shoqëritë janë të ndryshme, por e drejta për të jetuar të lirë dhe në paqe është e njëjtë.

Të diskriminosh tjetrin

Sikur të gjithë njerëzit të ishin modestë aq sa janë injorues, do të kishim jetuar pa frikë dhe me shumë qetësi “mos fol ti”, “ku di ti”, “nuk mund të shkosh në shkollë”, “zezak” janë disa fjalë e fjali të cilat dëgjohej shumë në jetën e përditshme. Çdo njeri që në momentin e lindjes së tij gëzon të drejtën “të jetojë”, pavarësisht moshës, racës, gjinisë apo edhe fesë. Sot bëhen shumë padrejtësi ndaj shumë personave të moshave të ndryshme - sidomos fëmijëve. Ata nuk munden as

“Të gjithë njerëzit janë të lirë dhe të lindur me të drejta dhe dinjitet të barabartë”. Kështu fillon Neni I Deklaratës së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Të gjithë ne, sapo lindim, kemi të drejta të caktuara, të quajtura të drejta të njeriut.



të flasin, as të shprehen, as të veprojnë siç ata mendojnë, madje nuk munden as të shkollohen. Shumë fëmijëve nuk u lejohet shkollimi dhe ndaj tyre ushtrohet diskriminim i vrazhdë nga persona të ndryshëm, të pandërgjegjshëm. Ata detyrohen të punojnë punë të rënda fizike, por edhe në rrugë. Shumë fëmijë madje janë lypsharë dhe viktimë të dhunës që ushtrohet mbi ta, në mënyrë që të punojnë për persona që i keqtrajtojnë. Shumë nxënës e studentë nuk munden as të shkollohen, disa nga frika se fyhen vetëm pse janë me ngjyrë, e disa të tjerëve (vajzave) u ndalohet kjo e drejtë sepse janë të mbuluara, apo diku tjetër se janë të pambuluara. Si të mund të shkojë në shkollë një vajzë me ngjyrë? Këto dhe shumë pyetje të tjera do të duhej të kishin përgjigje deri sot, por që fatkeqësisht nuk ndodh kështu. Të gjithë jemi njerëz, të gjithë kemi të drejta të barabarta pavarësisht moshës, gjinisë, fesë apo racës. Sikur të gjithë njerëzit të ishin modestë aq sa janë injorues, do të kishim jetuar pa frikë dhe me shumë qetësi.

Të mos shijosh fëmijërinë

Fëmijët shndërrohen në mbajtës të familjes dhe rrezikojnë shëndetin dhe ardhmërinë e tyre, nuk kanë një arsim cilësor dhe kushte për shkollim. Ideja e të drejtave të njeriut dhe e lirive njerëzore është shumë e vjetër. Për liritë dhe të drejtat e njeriut është menduar në të gjitha epokat e zhvillimit të shoqërisë. Në disa shoqëri mesjetare, e drejta e njeriut përcaktohej si e drejtë natyrore. Askush nuk mund t'ia mohonte njeriut të drejtat, madje as mbreti, pavarësisht se sa fuqi kishte ai. Të drejtat e njeriut ndryshonin varësisht prej sistemeve shoqërore politike, nëpër të cilat kalonte njerëzi-

mi. Me vite të tëra të drejtat e njeriut kanë qenë të shkelura mizorisht. Këto shkelje ishin rezultat i padrejtësisë, diskriminimit dhe paragjykitimit ndaj popujve të ndryshëm. Pa liri, pa barazi jeta vazhdonte të ishte e ashpër dhe tepër e vështirë. Drejtësia nevojitej të mbronte çdo njeri dhe të vendosej rend dhe rregull në shoqëri. Por, edhe sot po vazhdojnë të shkelen të drejtat, sidomos tek fëmijët të cilët detyrohen të punojnë. Këta fëmijë duhet të ishin duke shijuar jetën, e jo të shfrytëzohen si fuqi punëtore, e disa të tjerë të shesin cigare nëpër kafene dhe në rrugë, për të fituar bukën e gojës. Më ndodh çdo ditë të shoh fëmijë që kërkojnë lëmshë: “Më jepni 10 leke ju lutem”, “Zoti ju ndihmoftë”. Fëmijët për shkaqe ekonomike detyrohen të braktisin mësimin dhe të punojnë punë të rënda, punë këto të ndaluara me të gjitha konventat për të drejtat e fëmijëve. Fëmijët shndërrohen në mbajtës të familjes dhe rrezikojnë shëndetin dhe ardhmërinë e tyre, nuk kanë një arsim cilësor dhe kushte për shkollim. Për këtë arsye them se fëmijët kanë një ardhmëri të pasigurt. Organizata vendëse e ndërkombëtare në të gjithë botën janë angazhuar dhe angazhohen vazhdimisht të zgjidhin probleme që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Për t'i kuptuar më lehtë të drejtat e njeriut, ato janë ndarë në ka të grupe kryesore:

- të drejtat elementare personale,
- të drejtat civile dhe politike,
- të drejtat sociale dhe ekonomike dhe të drejtat për ambientin.

E drejta personale është e drejtë për jetën. Për të jetuar njeriu duhet të jetë i lirë, të shprehet lirisht, të lëvizë lirisht, të krijojë marrëdhënie pune etj. Të drejtat civile dhe politike

iu takojnë personave mbi moshën 18-vjeçare, të cilët e kanë të drejtën e votës e zgjedhjes së lirë. Në të drejtat sociale dhe ekonomike hyjnë të drejtat sociale, të drejtat për mbrojtjen shëndetësore etj. Këto të drejta ndryshe quhen të drejtat e brezit të dytë. Të drejtat për ambientin quhen të drejtat të brezit të tretë dhe funksioni i tyre është mbrojtja e natyrës.

Si e kam kaluar unë fëmijërinë time?

Më pëlqente të ecja zbathur në barin e lagur, të merrja rreze dielli në det dhe të rrokullisesha në lëndinat e gjelbra. Dilja nga shtëpia pa çadër, sepse adhuroja të ndieja shiun në fytyrë, dhe borën që më hidhte vellon e saj të bardhë. Këto janë gjëra kaq të vogla, por janë kujtime të paharrueshme që herë pas here më lejojnë të rikthehem në fëmijërinë time të lumtur. Dhe qëkur jam bërë nënë, ka akoma më tepër momente të tilla – djali im më mësoi se si të jem më e lumtur dhe më entuziaste, se si ta shikoj botën me ngjyra dhe në një kohë të zymtë me mjegull dhe shi. Im bir ndalonte menjëherë për të parë një milingonë në rrugën e djegur nga zhegu i korrikut, dhe e vështrohte me gjithë dashamirësinë e një fëmije, ndërsa unë, nëna e tij e shkela me këmbë. Punë të rriturishiu përgjigja shikimit të përlotur të tij. Më duhet të shoh me sytë e zemrës së tij mendova me vete, dhe bota do ketë dashurinë e munguar.

Le ta mbajmë gjallë fëmijën brenda nesh sepse të jesh fëmijë është diçka e mrekullueshme dhe nuk ia vlen të rrites.

Për më tepër, kështu ne mund të festojmë Ditën e Fëmijëve çdo ditë të vitit. Ajo çfarë fëmijët duan vërtet për

1 Qershorin dhe gjatë gjithë jetës së tyre, është të kalojnë kohë cilësore me prindërit e tyre.

Jo të gjithë fëmijët në

Shqipëri janë të lumtur

Institucioni i parë ku u shkelen të drejtat fëmijëve është familja. Sepse ndonjëherë prindërit mendojnë se fëmija është pronë e tyre duke e trajtuar atë si duan. Mirëpo ata nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë. Kjo nuk është një ndikim i mirë tek fëmija.

Prindërit e sotshëm duhet të jenë shumë të kujdesshëm kur ata prindërojnë, sepse prindërimi i sotëm nuk është më i ngjashëm me të djeshmin.

Adoleshentët e sotëm urrejnë dy gjëra: prindërit në familje dhe mësuesit në shkollë. Kjo për faktin se ata e urrejnë shumë fjalën mos. Familja e sotme nuk është e ngjashme me të djeshmen. Mendoj se duhet të gjejmë një balancë midis atij rregullit të prerë për të thënë jo dhe lirisë me qëllim për të qetësuar gjërat.

Familja dje ka qenë më tepër maskiliste dhe fëmijëve nuk mund t'ua imponosh një gjë të tillë. Kjo mënyrë sjellje që prindërit janë lart dhe fëmijët në fund ka marrë fund sot. Familja shqiptare po shkon drejt demokratizimit dhe mendimi për t'i mposhtur këta të rinj është tërësisht metoda e gabuar. “Prandaj na duhet të ecim me hapin e tyre, dashurinë, kujdesin dhe sjelljen tonë prindërore, për të qenë shokët e tyre por në fund për t'u kujtuar që ne jemi jetëdhënësit e tyre dhe si të tillë duhet të duhemi dhe respektohemi pa kushte.” Vetëm kështu do jemi në gjendje të bëjmë një shoqëri pa vese dhe me vlera morale.

Çdo njeri bëhet më i mirë para sinjeritetit të fëmijëve, që reagojnë në çdo çast dhe për çdo gjë. Mjafton të shikosh sytë e tyre dhe je para provimit më të madh në jetë. Çdo prind kërkon më të mirën për fëmijën e vet, por nuk duhet ekzagjeruar dashuria për ta. Në kohët e para, fëmijët kënaqeshin me pak lodra të sajura, ndërsa tani prindërit e shoqëria duhet të bashkëpunojnë si t'i ruajnë fëmijët nga të ashtuquajturat lodra, që i çojnë drejt instinkteve jo të mira.

Në këtë ditë të shënuar u them prindërve: Dhurojuni fëmijëve sa më shumë libra dhe praninë e tyre të domosdoshme! Kushtojuni kohë dhe vëmendje fëmijëve, sepse që në moshë të vogël, ata marrin drejtimin në jetë!

Gëzuar 1 Qershorin të gjithë fëmijëve të çdo shqiptari kudo që ata ndodhen!

Një urim të veçantë për fëmijët e familjes sonë të madhe, për fëmijët e ushtarakëve shqiptarë! Njerëzve të sakrificës dhe vetëmohimit.

Gëzuar 1 Qershorin edhe ju vogël-lushë që nuk ndjetë aromën e baba-llarëve tuaj rënë në krye të detyrës, që e ardhmja juaj të jetë e bukur dhe paqë si bota e ëndrrave tuaja!

“Tre gjëra na kanë mbetur nga paraaja: yjet, lulet dhe fëmijët”

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s viziton Uashington D.C.

“Implikimet e luftës së Rosisë në Ukrainë dhe Samiti i NATO-s në Madrid”

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg vizitoi Uashington D.C. për të diskutuar me zyrtarë të lartë amerikanë implikimet e luftës së Rosisë në Ukrainë dhe përgatitjet për samitin e NATO-s në Madrid. Gjatë vizitës së tij zyrtare në SHBA, (31 maj-3 qershor 2022), Sekretari i Përgjithshëm u takua me Sekretarin e Shtetit Antony Blinken, të mërkurën, më 1 qershor. Bisedimet u fokusuan mbi diskutimet në luftën e Rosisë kundër Ukrainës, si dhe mbi përgatitjet e Samitit të NATO-s në Madrid.

Në takimin me Sekretarin e Shtetit Anthony Blinken, Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Shtetet e Bashkuara për rolin e tyre të domosdoshëm në përgjigjen e NATO-s ndaj pushtimit rus të Ukrainës. Ai deklaroi se mbështetja e fortë e NATO-s dhe aleatëve për Ukrainën ndihmon të sigurohet që agresioni i Presidentit Putin të mos shpërblehet dhe që Ukraina të triumfojë.

Më vonë Sekretari i Përgjithshëm u takua me Sekretarin e Mbrojtjes Lloyd Austin dhe Këshilltarin e Sigurisë Kom-bëtare Jake Sullivan.

Sekretari i Përgjithshëm mbajti gjithashtu një fjalim në Shkollën e Studimeve Ndërkombëtare të Avancuara të Universitetit Johns Hopkins (SAIS), dhe në 2 qershor, ai dha një Deklaratë e përbashkët me Sekretarin e Mbrojtjes të SHBA-së.

Implikimet e luftës së Rosisë në Ukrainë dhe mbështetja e NATO-s

Pas takimit me Sekretarin Amerikan të Shtetit Antony J. Blinken, gjatë vizitës së tij në Shtetet e Bashkuara, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg dhe Sekretari Blinken dhanë një Konferencë të përbashkët për shtyp.

Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Shtetet e Bashkuara për rritjen e pranisë së saj ushtarake në të gjithë Europën dhe theksoi se parandalimi i fortë i NATO-s po ndihmon në heqjen e çdo hapësire për llogaritje të gabuara në Moskë në lidhje me gatishmërinë e NATO-s për të siguruar dhe mbrojtur të gjithë aleatët. “Faleminderit për angazhimin tuaj të fortë personal në lidhjen tonë transatlantike në këtë kohë kyçe për sigurinë tonë dhe kjo reflektohet shumë në vizitat tuaja të shpeshta në Bruksel. Jeni të mirëpritur të ktheheni përsëri atje, por tani e vlerësoj vërtet këtë mundësi për t’u takuar me ju këtu në Uashington. Shtetet e Bashkuara po luajnë një rol të domosdoshëm në përgjigjen tonë ndaj pushtimit rus të Ukrainës. Më lejoni të përgëzoj Shtetet e Bashkuara për mbështetjen tuaj shumë të rëndësishme për Ukrainën, e cila çdo ditë po bën ndryshim në fushën e betejës. Unë mirëpres gjithashtu paketën e fundit të ndihmës ushtarake të shpallur nga Presidenti Biden këtë mëngjes. Ky është një demonstrim i lidershit të vërtetë amerikan. Mbështetja e fortë e ofruar nga NATO dhe aleatët ndihmon për të siguruar që agresioni brutal i Presidentit Putin të mos shpërblehet dhe Ukraina të triumfojë. Në të njëjtën kohë, ne duhet të parandalojmë përshkallëzimin e konfliktit”, -u shpreh tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, duke theksuar se aleatët europianë dhe Kanadaja po rriten gjithashtu me më shumë trupa, gatishmëri më të lartë dhe rritje të shpenzimeve për mbrojtjen: “Ne kemi rritur praniën tonë në pjesën lindore të Aleancës. Për të hequr çdo hapësirë për llogaritje të gabuara në Moskë në lidhje me gatishmërinë dhe vendosmërinë e NATO-s për të siguruar dhe mbrojtur të gjithë aleatët e NATO-s dhe më lejoni të falënderoj Shtetet e Bashkuara për rritjen e pranisë tuaj ushtarake në të gjithë Europën. Me mbi 100 000 trupa, të mbështetur nga fuqi të konsiderueshme ajrore dhe detare. Aleatët europianë dhe Kanadaja po rriten gjithashtu me më shumë trupa, gatishmëri



Anëtarët e Komisionit European të Rajoneve për Mjedisin, Ndryshimet Klimatike dhe Energjinë (ENVE) theksuan në takimin e tyre, më 31 maj se kursimi i energjisë do të jetë mënyra më e pastër dhe më e menjëhershme për të rritur pavarësinë nga energjia ruse dhe nënvizuan se rajonet dhe qytetet duhet të vazhdojnë të jenë organet kryesore politike në mbështetje të qytetarëve të cilët janë më të prekur nga rritja e çmimeve të energjisë. Ata theksuan më tej se pavarësia nga energjia ruse është vetëm një hap tjetër drejt energjisë më të qëndrueshme në BE dhe se problemet mjedisore mbeten ende, veçanërisht në zonat rurale.

Duke hapur debatin mbi implikimet e luftës në Ukrainë për qytetet dhe rajonet që përballen me krizën energjetike, Kata Tűtő (HU/PES), kryetarja e Komisionit ENVE dhe zëvendës kryetarja e Bashkisë së Budapestit, deklaroi: “Çmimet e larta të energjisë të qëndrueshme dhe ndërprerja e furnizimi me energji, i shkaktuar nga lufta e paligjshme e Rusisë në Ukrainë po dëmtojnë një pjesë të madhe të ekonomive tona dhe po përkeqësojnë varfërinë e energjisë dhe lëvizshmërisë. Propozimet brenda planit REPowerEU duhet të jenë mënyra për të përshpejtuar ndjeshëm tranzicionin e energjisë së pastër, duke hequr gradualisht varësinë tonë nga karburantet fosile,



dhe jo vetëm diversifikimin e furnizimit të tij. Ne, qytetet dhe rajonet, jemi në qendër të reagimit ndaj urgjencës në këtë krizë me synimin për rritjen e burimeve të rinovueshme, maturinë e energjisë dhe mjaftueshmërinë në komunitetet tona. Prandaj, ne bëjmë thirrje për njohjen e këtij roli në Planin REPowerEU.”

Komiteti European i Rajoneve (CoR) ka nisur së bashku me Paktin e Kryetarëve të Bashkive dhe Komisionin European “Cities Savings Energy Sprint”, një fushatë komunikimi në formën e një pakete mjeteve që do të ndihmojë qeveritë vendore të reduktojnë konsumin e energjisë bashkiake dhe të inkurajojë qytetarët dhe biznesin lokal të marrin masa të ngjashme.

Gjithashtu, anëtarët e Komisionit ENVE miratuan tre draft-opinionet e mëposhtme gjatë mbledhjes:

-Tranzicioni ekologjik - i cili bën balancimin midis pranueshmërisë sociale dhe imperativave mjedisore për të ndërtuar komunitete elastike nga këndvështrimi i qyteteve dhe rajoneve, nga raportuesja Hannah Zdanowska (PL/EPP), krye-bashkiake e Łódź, e cila deklaroi: “Diversifikimi dhe pavarësia e Europës nga energjia ruse burimet janë një nga prioritetet. Sigurimi i aksesit në burimet e ngrohjes dhe energjisë për të gjithë, duke përfshirë më pak të pasurit, është një tjetër. Ne duhet të punojmë për efikasitetin e energjisë dhe zhvillimin sa më të shpejtë të energjisë së rinovueshme. T'i bëjmë qytetet tona elastike është një recetë për mbijetesën, konkurrencën dhe atraktivitetin e qyteteve dhe rajoneve tona për banorët dhe investitorët.”

-Rishikimi i Direktivës së Performancës së Energjisë së Ndërtesave nga raportuesi André Viola (FR/PES), Anëtar i Këshillit të Departamentit të

Aude, i cili deklaroi: “Nëse duam të ulim faturat tona të energjisë dhe të përbushim objektivat tona klimatike deri në vitin 2050, duhet të jemi ambicioz. Në dekarbonizimin e stokut të ndërtesave të BE-së dhe luftimin e vërtetë të varfërisë energjetike. Ne duhet të kemi një plan të vetëm rinovimi që mund të zbatohet me vite, i cili duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe financiarisht i qëndrueshëm. Rishikimi i direktivës duhet të fokusohet në të gjithë ciklin jetësor të ndërtesat dhe futja e ekonomisë rrethore në të gjitha fazat. Kjo do të ndodhë vetëm nëse burimet e duhura financiare dhe teknike do të vihen në dispozicion të qyteteve dhe rajoneve.”

-Buxheti i gjelbër i vënë në praktikë në nivel lokal dhe rajonal, nga raportuesi Vincent Chauvet (FR/RE), kryetar i Bashkisë Autun, i cili deklaroi në takim: “Buxhetimi i gjelbër duhet të jetë një mënyrë se si ne të gjithë i afrohem buxheteve tona lokale dhe rajonale në të ardhmen e afërt për t'i përfshirë mirë politikat tona buxhetore me qëllimet mjedisore. Mund të ndihmojë qeveritë vendore të priorizojnë dhe të zgjedhin projektet dhe shpenzimet e investimeve me karbon të ulët dhe elastik, lehtëson dhe përmirëson racionalitetin e vendimeve, kontribuon në përmirësimin e vlerësimit të politikave publike dhe përgjigjet ndaj një kërkesë në rritje të transparencës dhe llogaridhënies për veprimet publike të qeverisë lokale. Kjo gjithashtu ngre disa sfida për bashkitë dhe rajonet. Kjo është arsyeja pse ato do të kenë nevojë për një mbështetje të fortë nga Komisioni European në përcaktimin e ‘objektivave të buxhetit të gjelbër’ në nivel lokal dhe rajonal, mjetet, metodologjitë, treguesit e performancës dhe një listë zërash buxhetorë për buxhetimin e gjelbër vendor dhe rajonal”.

NASA ka gjetur mënyrën për të ulur njerëzit në sipërfaqen e Marsit

NASA ka ndarë informacionin e saj më të fundit se si prezantojnë misionin e parë të drejtuar në Mars. Më 17 maj, agjencia shpali idetë për uljen në sipërfaqen e Marsit me pjesëmarrjen e dy personave dhe i kërkoi publikut të shprehte mendimin e tyre se si po shkon planifikimi, shkruhet në “The Universe. Space. Tech”



NASA planifikon të dërgojë astronautë në Mars deri në fund të viteve 2030 ose në fillim të viteve 2040.

NASA planifikon të dërgojë astronautë në Mars deri në fund të viteve 2030 ose në fillim të viteve 2040. Nuk do të jetë e lehtë për ta bërë realitet këtë vizion. Edhe me teknologjinë më të avancuar, koha e fluturimit vajtje-ardhje do të zgjasë ende rreth 500 ditë, duke pasur parasysh distancën midis Tokës dhe Marsit.

Gjatë fluturimit, astronautët do të kenë një problem të madh me mungesën e gravitetit. Prandaj, pionierët do të duhet të bëjnë një rrugë të gjatë për të rikthyer tonin e muskujve për të punuar edhe në kushtet e gravitetit të pjesshëm të Marsit, që është rreth 1/3 e gravitetit të Tokës. NASA sugjeron se një mënyrë për të zgjidhur këtë problem mund të jetë vendosja e ekuipazheve në një rover të mbyllur gjatë misionit të tyre.

Automjetet e përshtatshme për të gjitha llojet e terrenit do të ndihmojnë astronautët të lëvizin në sipërfaqen e Marsit.

“Ideja është që të përdoren automjete me rrota në vend që të ecin me një kostum hapësiror të rëndë, i cili do të zëvendësojë këmbët e tyre në mënyrë që të mund të rikuperohen dhe të mos e ekspozojnë trupin ndaj ngarkesave të papritura”, -tha Kurt Vogel, drejtor i arkitekturës hapësirore të NASA-s.

Agjencia Hapësirore synon të përdorë një anije kozmike me një habitat artificial për të dërguar anëtarët e ekuipazhit në Planetin e Kuq duke përdorur një skenë rakete hibride me një motor kimik dhe elektrik. Ekuipazhi i parë do të përbëhet nga katër persona, dy prej të cilëve do të zbrisin në sipërfaqe, e cila është disi e ngjashme me modelin e paraqitur në programin Apollo me tre astronautë.

Për të kursyer hapësirë dhe për të zvogëluar peshën e tokës, 25 tonë furnizime dhe pajisje do të dërgohen në një mision automatik të veçantë në Mars përpara se astronautët të zbrisin në sipërfaqe. Misioni do të dërgojë një raketë në Planetin e Kuq për të kthyer ekuipazhin në modul orbital, i cili gjithashtu do t'i ndihmojë ata të kthehen në Tokë.

Më parë, SpaceX premtoi të pushtonte Marsin më herët se NASA.

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

**Dashuri për njerëzit
dhe fshatin Kuç**

U mblodhëm në Kuç në 65-vjetorin e lindjes së Dr. Asllan Zemanit, për të bërë gëzuar me përgjegjësin e muzeut të FA-së. Ishte një dëshirë e stafit të muzeut, për të parë krahinën e Labërisë, rrugën e lumit të Vlorës, por dhe Kuçin heroik dhe të martirizuar që në shekuj ka bërë histori dhe ka lënë gjurmë në kujtesën kombëtare. Është një gjë fisnike që Dr. Asllan Zemani e ka marrë nga prindërit e tij, dashurinë për fshatin dhe njerëzit e tij, pavarësisht se nuk ka lindur aty, por në Tiranë, ku dhe prindërit ishin me punë.

Si bir i Kuçit të Kurveleshit, i njohur për atdhetarizëm, për trimëri, për njerëz luftëtarë dhe punëtorë të punës dhe të dijes, u edukua dhe u kalit në jetë që gjithmonë t'i vlonte në zemër e në mendje fshati heroik dhe Tirana ku lindi. Asllan Zemani që në fillimet e jetës, të karrierës ushtarake dhe intelektuale u mbrujt me dhembshuri për vendlindjen e dashur, ku për vite të tërë mban lidhje të vazhdueshme, ku në çdo bisedë e takim, të flet për ata njerëz e për ato histori e zakone të cilat i kujton me nostalgji dhe me një dashuri të pakufishme. Këtë vlerë të tij, unë e kam parë në lidhjet e vazhdueshme që mban me të gjithë kuçiotët që janë në Tiranë, si në gëzime dhe hidhërime e gjithmonë iu gjendet pranë.

Asllan Nurçe Zemani ka lindur më 21 prill 1957 në qytetin e Tiranës. Familja e tij ishte një familje atdhetare dhe patriotike, dhe ka dhënë një ndihmesë në LANÇ dhe në ndërtimin e vendit. Gjyshi i tij Bedin Myftar Demiraj ishte nga të parët anëtar i këshillit nacionalçlirimtar i fshatit, si dhe drejtoi në luftime batalionin territorial "Ismail Haki" të Kuçit gjatë operacioneve të zhvilluara në Luftën e Dytë Botërore. Babai, Nurçe, ka qenë oficer në specialitetin e ndërlihdjes dhe ka punuar në repartet e njësitë e ndryshme të ndërlihdjes në Forcat e Armatosura. Ndërsa nëna, Sanie, ka punuar për një kohë të gjatë si infermiere në ndërmarrje të ndryshme të Tiranës. Prindërit e tij, kanë qenë të përkushtuar dhe të dalluar në sektorët ku kanë punuar.

Me horizontin dhe kulturën e tij, Asllan Zemani është përpjekur me kujdes për zbërthimin dhe konkretizimin e trashëgimisë morallo-shoqërore e kulturore që kanë pasur brezat e familjes së tij në Kuç. Në çdo aktivitet të zhvilluar në fshatin Kuç, Asllani nuk ka munguar dhe në çdo rast ka qenë i pranishëm dhe ka dhënë kontributin e tij modest.

Asllani në familjen e tij, që krijoi së bashku me Mira Nakuçin, një oficer shembullorë e specialitetit të Ndërlihdjes, e vazhdoi traditën ushtarake të babait të tij. Së bashku ata rritën, mësuan dhe edukuan djalin Lisien Zemani dhe vajzën Bora Zemani, e njohur për publikun dhe të rinjtë me emisionet e saj televizive të pëlqyera prej rinisë.

**Në shkollë dhe në punë
gjithmonë korrekt**

Ish-nxënës i gjimnazit "Qemal Stafa", të cilin e mbaroi me rezultate të mira në vitin 1976, eci në arsimimin e tij në të gjitha nivelet e shkollimit, duke u dalluar për rezultate, për zgjuarsin dhe kurajë në ngritjen dhe trajtimin e problemeve të kohës, si dhe në detyrat në cilat punoi e drejtoi. Duke vlerësuar dëshirën e prindërve për t'u bërë oficer, ndoqi studimet e larta në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe në vitin 1981 u titullua oficer dhe u emërua në

Asllan Zemani, studiues i historisë ushtarake dhe veprimtar shoqëror

(Në 65-vjetorin e lindjes së tij)



detyrën e shefit të stërvitjes në brigadën e këmbësores në qytetin e Librazhdit, ku punoi për përgatitjen dhe stërvitjen e ushtarëve. U dallua në përgatitjen luftarake dhe në stërvitjen e vogël duke dhënë rezultate të larta në stërvitje dhe në qitje luftarake. Më tej transferohet me detyrë shef i stërvitjes në repartin ushtarak të qytetit të Lezhës, ku punoi deri në vitin 1989. Për rezultate të dukshme në të gjitha stërvitjet e zhvilluara, iu dha e drejta për të ndjekur studimet në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë. Me përfundimin e akademisë dhe për rezultate të dukshme u emërua komandant batalioni në njësitë e Tiranës. Këtu u dallua në studimin e disa treguesve të stërvitjes me batalionin e këmbësores dhe filloi të botojë shkrime nga aspekte të jetës dhe të veprimtarisë së repartit. U shqua në disa përgatitje teorike, si dhe tërhoqi vëmendjen në shkrimet e tij, për historinë ushtarake dhe përvojën luftarake të popullit tonë në shekuj.

Në rrugën e shkencës ushtarake

Me ndryshimet që po ndodhnin në ushtri dhe reformën që po bëhej hap pas hapi, në vitin 1993, për rezultate të dukshme u emërua punonjës shkencor dhe pedagog në Akademinë e Mbrojtjes, në departamentin e Historisë Ushtarake. Ishte kjo një mundësi e mirë për të thelluar më tej njohuritë dhe për të filluar një punë kërkimore shkencore, ku vet institucioni i Akademisë e kishte përparësi. Kështu menjëherë filloi specializimet, kualifikimet shkencore e profesionale. Nisi punën studimore dhe filloi të kërkonte materiale të historisë në arkiva. Nga departamenti i historisë iu caktua përgatitje e disertacionit me temë "Organizimi i formacioneve ushtarake të Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare".

Krahas punës që bënte si pedagog në lëndën e historisë ushtarake, filloi dhe përgatitjet për provimin universitar për lëndën "Historia e shek. XX" në Fakultetin e Historisë në Universitetin e Tiranës, studime në Arkivin e Shtetit dhe në Arkivin e Forcave të Armato-



sura, takime me veteranë, njohje me shkrime të botuara dhe dorëshkrime të propagandistëve të luftës etj. Më tej dha provimin pasuniversitar në lëndën e Historisë Ushtarake, si dhe u bë pjesë e disa aktiviteteve kombëtare në nivele të ndryshme, në seminare, në trajnime dhe në shkrime në shtypin e kohës. Gjatë këtyre viteve punoi për të gjetur të dhëna mbi formacionet ushtarake të Ballit Kombëtar e Legalitetit, ku ka marrë pjesë në tryeza të rrumbullakëta me historianë të Institutit të Historisë, të AQFA, të AQSH, me Qendrën Kul-

ture të Ushtrisë, etj. Në shtypin ushtarak shkroi dhe trajtoi figura ushtarake, si figura ushtarake e Hysni Lepenicës dhe Lufta e Gërhotit në vitin 1943, etj. Kjo veprimtari shkencore dhe përgatitje serioze bëri që në vitin 2000 të paraqesë temën e disertacionit dhe mori gradën shkencore "Doktor i shkencave në fushën ushtarake".

Në të gjitha detyrat e ngarkuara nënkoloneli Asllan Zemani nga punonjës shkencor e pedagog në QSS të KDS-së, drejtor i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura në vitet 2004-2008, shefi i Sektorit të Didaktikës (DUU) në Akademinë e Mbrojtjes, pedagog në Masterin Shkencor për temat e "Politikave të Sigurisë dhe të Mbrojtjes" pranë Akademisë së Mbrojtjes "Spiro Moisiu", pedagog në Masterin Profesional për temat të "Administratës vendore dhe të organizimit të saj", në universitetin jopublik, specialist në Qendrën e Librit në KDS-së dhe në vitet 2014-2022 përgjegjës në Muzeun e Forcave të Armatosura, shfaqti dukshëm cilësitë e një drejtuesi me një botë të pasur shkencore dhe me një përvojë pune që vinte nga praktika e përditshme e jetës ushtarake.

Dr. Asllani në tërë veprimtarinë e tij shkencore çështjet i trajton me kompetencë shkencore dhe me dimensionin e duhur historik për çdo periudhë, por dhe të brezave të kaluar, duke mos i ndarë nga situata aktuale në të cilën kalojmë dhe përjetojmë. Me forcën intelektuale që e karakterizon në çdo kohë dhe situatë, ai me dashamirësi ka pasqyruar cilësitë e bukura me vlerat më të mira, në portretizimin shpirtëror të figurave patriotike dhe atdhetare të fshatit, të cilat kanë shërbyer për të rritur në nivele e pozicione të reja kre-

narinë e gjithanshme të tyre. Ai gjithmonë është gjendur në ballë të kësaj lufte. Ndaj dhe sot lufton dhe punon me përkushtim që të nguliten dhe të fiksohen në kujtesën e të rinjve, vlerat dhe virtytet më të rëndësishme të cilësive si të ndershmërisë, të patriotizmit, të atdhedashurisë që duhet të karakterizojë brezat pasardhës të Shqipërisë.

Muzeu i FA-së ka mbi 10 vite që po funksionon më së miri. Në këto vite të drejtimit nga Dr. Asllan Zemani muzeu ka pasuruar fondin, si dhe ka bërë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që i duhet një muzeumi për t'u quajtur i vizitueshëm nga publiku. Në vetvete ai ka krijuar mini-muze sipas degëve, armëve dhe shërbimeve, gjë që ka rritur më tej cilësinë e paraqitjes së tyre, por dhe pasqyrimin të mjaft objekteve ushtarake. Një kontribut për zhvillimin dhe pasurimin e tij në këto vite ka dhënë dhe përgjegjësi i muzeut të FA-së Dr. Asllan Zemani.

**Veprimtaria botuese
dhe shoqërore**

Në të gjithë këtë rrugëtim mbi 40 vjet në shërbim në FA-së, Dr. Asllan Zemani ka lënë gjurmë në botimin e mjaft shkrimeve, kumtesave, studimeve dhe librave të publikuara. Ai është bashkautor në librat e publikuara si "Personalitete ushtarake shqiptare në vite" (1912-1997), vëllimi 1, "Historia e Ushtrisë Shqiptare", (Organizimi), 1912-1944, vëllimi I, "Albanian Armed Forces in Photos", "the History, Graziani Arti Gra-fiche-Corato" Bari, Itali dhe "Agresion ushtarak, gusht '49". Në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të vitit 2008, është autor i disa zërave të mesëm dhe zërave të vegjël të botuar. Ai ka bërë recensën e mjaft librave të botimeve ushtarake, duke dhënë një ndihmesë të dukshme në trajtimin e mjaft çështjeve dhe të dukurive të historisë ushtarake, të botuara në gazetën "Ushtria", në "Revistën Ushtarake" në "Revistën për Studime të Historisë Ushtarake", në "Revistën Studime Muzeologjike" etj.

Vlerë e tij e dukshme janë dhe veprimtaritë e aktiviteteve që ka realizuar me "Vëllazërimin Kuçiot" në Tiranë, ku ju flet dhe ju ushqen pasione shpirtërore të vendlindjes dhe të trevës së Lumit të Vlorës dhe të Labërisë. Duke qenë i zgjedhur në degën e Tiranës, por dhe në Shoqatën "Vëllazërimin Kuçiot" në Tiranë, ai ka dhënë dhe jep një kontribut me vlera për trajtimin, shtjellimin dhe evidentimin e traditave dhe virtyteve më të mira kuçiotë, por dhe të Labërisë. Në shoqatën "Labëria", Dega Tiranë, Asllani është shquar për punë të palodhur, për mendime e sugjerime në organizimin e punës, dallohet për korrektësi shembullore, i pa përtuar dhe kurrë nuk ka kërkuar merita e vlerësime për veten e tij.

Për të gjithë ne që bashkëpunojmë me Dr. Asllanin ka qenë dhe është një kënaqësi dhe vlerë, ndërsa për mua, e them sinerisht dhe me shpirt, është një shok që më fal mirësi, dashuri, bujari dhe sineritet në këto vite të njohjes e në këtë detyrë shoqërore. Respekt dhe mirënjohje për Dr. Asllanin dhe të jetë përherë veprimtar i palodhur për FA-në, për Kuçin dhe Labërinë, urime dhe gëzuar 65-vjetorin!

Gëzim Lilo, 30-vjeçari nga Erseka, që ra në krye të detyrës në brigadën xheniere të urave, vinte nga një familje me tradita atdhetare e punëtore, kishte lindur më 9 shkurt viti 1957 në fshatin Radonjë të Kolonjës, kryen arsimin 8-vjeçar në vitet 1964-1972 në fshatin e lindjes. Në vitet 1972-1976 kryen studimet me rezultate të shumë të mira në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”, dega mekanike.



NJË LAMTUMIRË PËR USHTARAKUN E DJEGUR...

Ushtaraku Gëzim Lilo ra në krye të detyrës

Ka qenë nëntor i vitit 1987, kur toga me ushtarë përcollën me makinën “Zis” nga Kavaja në Radonjë të Ersekës trupin e djegur të komandantit të tyre, Gëzim Lilo. Në mëngjesin e fund-nëntorit dërgata me ushtarë mbërriti në shtëpinë e të ndjerit, duke tronditur thellë familjarët dhe mbarë fshatin e vogël buzë kufirit në Jug. U zhvillua ceremonia mortore, u mbajt fjalë e rastit nga përfaqësuesi ushtarak, foli dhe kryetari i frontit, u vendosën kurora dhe batoreja e armëve të shokëve të Gëzimit. Lajmi i kobshëm, befasia dhe shpejtësia e zhvillimit të riteve të lamtumirës së 30-vjeçarit të rënë në detyrë në Kavajë, lanë shumë pa sqaruar rrethanat në të cilat ai kishte ndërruar jetë...

Djaloshi nga Erseka që shërbeu në xhenio

Gëzim Lilo, 30-vjeçari nga Erseka, që ra në krye të detyrës në brigadën xheniere të urave, vinte nga një familje me tradita atdhetare e punëtore, kishte lindur më 9 shkurt viti 1957 në fshatin Radonjë të Kolonjës, kryen arsimin 8-vjeçar në vitet 1964-1972 në fshatin e lindjes. Në vitet 1972-1976 kryen studimet me rezultate të shumë të mira në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”, dega mekanike. Në periudhën njëvjeçare 1976-1977 kryen stazhin e punës praktike në Hidrocentralin e Fierzës, duke punuar me korrektësi, e i dalluar në të gjitha drejtimet si një kuadër i formuar ushtarak. Më pas ai kreu studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në vitet 1977-1980 me rezultate shumë të mira në specialitetin e xhenios. Ndërsa në vitin 1981 kryen stazhin si kuadër në rolin komandant toge, në batalionin e Urave të Lehta në repartin ushtarak në Kryeluz të Kavajës. Aty gjeti: komandant kompanie Jorgji Çekun, shef shtabi Zabit Cukun, komandant batalioni Mustafa Dervishin e komisar batalioni Baçe Ymerin. Më datë 18 maj 1981 titullohet oficer aktiv në specialitetin xhenier dhe emërohet në batalionin autonom të Urave të Lehta në Kryeluz Kavajë, me detyrë komandat toge “Moli” me 25 ushtarë aktivë.

I diplomuar oficer xhenier, e nisi karrierën ushtarake larg familjes, ndryshe nga shumë kolegë të tij që emëroheshin në zonat afër vendlindjes. Ai iu shtua korpusit të ushtarakëve, duke sjellë në gjirin e tyre, veç aftësive të larta profesionale, edhe frymën e traditave atdhetare të familjes së njohur e të vlerësuar të fisit të Lilove nga Erseka. Babai, Beqir Lilo, kishte qenë pjesëmarrës në Luftën Antifashiste, fillimisht në batalionin “Hakmarra” me komandant Petrit Dume dhe më pas në radhët e Brigadës XIV Sulmuese. Nga lufta i ati mbante disa dekorata për kontribute të veçanta në betejat me okupatorët e huaj. Pas çlirimit të vendit punoi në sektorë të ndryshëm të ekonomisë deri sa doli në pension. Po kaq, oficeri i ri ndihej krenar për cilësitë dhe bujarinë e nënës, e cila megjithëse një punonjëse e thjeshtë, ishte një grua e respektuar në fshat. Në këtë mjedis të shëndoshë kristalizoi personalitetin e tij djaloshi nga Erseka që shërbeu për gjashtë vite në repartin e xhenios në Kavajë. Ai iu përkushtua detyrës. Madje, jo vetëm kaq, por të renditej ndër oficerët shembullorë të garnizonit. I thjeshtë e i komunikueshëm me ushtarët, i papërtuar përballë kërkesave të detyrës, i kudo ndodhur në misionet e vështira të xhenios, Gëzim Lilo në pak kohë u bë i njohur në radhët e kolegëve dhe të banorëve të zonës.

Arti i xhenios për të nuk mbetej thjesht në kuadrin e punimeve për përgatitjen e urave, që në atë kohë ishin shqetësimi kryesor i regjimit.



Përtej këtyre, djaloshi nga Erseka, do ta ushtronte profesionin e tij edhe në shërbim të komunitetit. Kjo do ta afronte më shumë me specialistë të ndërtimit, me drejtues të ndërmarrjeve dhe të kooperativave për pengesat ujore që mund të krijoheshin në fatkeqësi të ndryshme natyrore, me të cilët shkëmbeu pa u kursyer ekspertizën dhe përvojën e tij. Po ashtu, kontributi i tij do të shfaqej herë pas here në kantieret e rrugëve dhe urave që lidhnin komunitetet me njëri-tjetrin. Ai vërtet ishte nga Erseka, madje nga një familje e thjeshtë fshatare, por nga mënyra si u integrua në shoqëri të linte përshtypjen se ishte i lindur në mjedisin kavajas. Të tilla mbresa ka lënë Gëzim Lilo te të gjithë ata që e lidhi puna dhe detyra. Shumëkush prej tyre ka të memorizuar në kujtesë, ngjarje e ndodhi ku shfaqen cilësitë dinjitoze të oficerit Gëzim Lilo. Po si ndodhi martirizimi i tij dhe cilat ishin çastet fatale të xhenierit 30-vjeçar?

Flakët që i morën jetën...

Ishte epoka e Luftës së Ftohtë, kur xhenierët ishin shtylla bazike e fortifikimit. Disiplina e xhenios është nga ato profesione që nuk toleron as gabimin më të vogël. Çdo kapërcim përtej normave dhe standardeve rigoroze, ka kosto fatale. Kanë ndodhur jo pak raste të tilla në historikun e armës së xhenios. Pak a shumë

kështu ndodhi atë natë të nëntorit të vitit 1987, me Gëzim Lilon, ku një pakujdesi e vogël e ushtarit të tij, i mori atij jetën tragjikisht. Duke qenë se kishte kryer edhe stazhin dhe kishte marrë njohuri e rezultate të larta vazhonte stërvitjen e efektivit që drejtonte me korrektësi e përkushtim për të përgatitur me nivel ndërtimin e pikave të kalimit, e të mbështetësve bregore të cilat luanin rolin kryesor në sigurinë e lidhjes dhe peshëmbajtjes së urës me gjatësi të ndryshme. Në këtë detyrë punoi deri vitin 1987, duke marrë pjesë në ndërtimin e pikave të kalimit me lundra, ura 12, 24 e 50 ton në lumenjtë Shkumbin, Vjosë, Lanë në Tiranë, Shkopet në Mat e në Drin. Ndër vite u dallua si një kuadër model me disiplinë, i përgatitur me komunikim shumë të mirë me vartësit dhe eprorët. Ishte shembull për kuadrot e tjerë me edukatë dhe respekt në çdo detyrë që merrte e kryente me përpikëri dhe pa ngjarje të jashtëzakonshme.

Më datën 25 nëntor 1987 ishte me shërbim në detyrën luftarake të oficerit të rojës. Çdo gjë gjatë shërbimit shkonte mirë, por gjatë natës ndodhi një shpëputje e energjisë elektrike në të gjithë repartin ushtarak, por dhe në zonën përreth. Për të siguruar ndriçimin, në zyrën e oficerit të rojës, në vendrojat e repartit dhe në centralin e ndërlidhjes, i dha porosi ushtarit

të gatshëm në central për të ndezur fenerin e vajgurit. Ushtari në përpjekje për ta ndezur i merr flakë feneri. Oficer Gëzimi në moment ia merr nga duart për ta hedhur sa më larg e për të mbrojtur ushtarin. Flaka e fenerit së bashku me vajgurin, i ranë mbi rroba dhe përhapet me shpejtësi. Duke qenë i veshur me uniformën e shërbimit: pantallona qillota, çizme të gjata dhe rripin e oficerit të shërbimit, i morën zjarr duke krijuar një nxehtësi dhe djegie në të dy këmbët.

Me gjithë ndihmën e dhënë në repart, në spitalet Kavajë e Durrës dhe së fundi në Spitalin Ushtarak, nuk mundi të përballojë djegien dhe ndërron jetë më 30 nëntor 1987. Kështu u bë dhe një oficer i rënë në krye të detyrës në shërbim roje në repartin e Urave të Lehta në Kavajë, në krye të detyrës luftarake. Kjo ishte një ngjarje e rëndë për familjen dhe për gjithë kolegët e xhenios. Në vijim u morën masa dhe u përcoll me respekt e nderime në familje dhe në banesën e fundit në Ersekë. Pavarësisht karrierës së shkurtër, Gëzim Lilo ishte një model kuadri ushtarak me nivel, i përgatitur dhe mjeshtër në përgatitjen dhe hedhjen e urave të lehta dhe të mesme. Ai mbetet shumë i nderuar për kolegët dhe të gjithë ata që e njohën e punuan bashkë, ai për punën, rezultatet e arritura është vlerësuar për çdo vit si kuadër shembullor dhe me stimuj nga instancat përkatëse.

Emri i tij duhet të jetë në panteonin xhenier

Arma e xhenios e krijuar më 20 janar 1921, për misionet luftarake, ka shënuar një histori suksesi jo vetëm në përmbushjen e detyrës, por edhe të mjaft operacioneve me karakter humanitar. Biografia 101-vjeçare e saj, që përshkruan periudhën e monarkisë, të Luftës Antifashiste, të viteve të Luftës së Ftohtë dhe të viteve të demokracisë është e mbushur me mjaft shembuj të tillë. Arma e xhenios dallon për numrin e madh të të rënëve dhe martirëve, një pjesë e të cilëve janë certifikuar me statusin e dëshmorit. Lista fillon me emrin e Panajot Haxhimihalit, xhenierit që u vra gjatë aksionit për çminimin e bregdetit të Durrësit menjëherë pas luftës dhe vijon me emrat e dëshmorëve Nuredin Gorçe, Aqif Karaj, Muhamet Hasmuja, Flamur Radani, Arben Hoxha, Fatmir Koka, Albert Lela, Vladimir Çurmaku, Bardhyi Këlliçi, Ferdinand Dosti, Mehmet Hysa, Sokrat Basha etj. Gëzim Lilo, djaloshi 30-vjeçar nga Erseka që ra në krye të detyrës luftarake në Kavajë, nuk e pati privilegjin të cilësohej dëshmor, megjithëse akti i tij ishte po aq vetëmohues e heroik, sa dhe i kolegëve të tij dëshmorë. Në arsyet e paarsyeshme të kësaj sjelljeje janë përmendur rëndom shkresat zyrtare të kohës që bëheshin pasi kishte ndodhur ngjarja e çdo gjë i lihej të ikurit... Familjarët, oficerë xhenierë dhe të njohur nuk kanë reshtur duke u interesuar në institucionet shtetërore, por askund s'kanë marrë një përgjigje. Përfundimisht, xhenieri i martirizuar në detyrë vazhdon të mbetet i destinuar për panteonin e harresës.

Teknologjitë e reja përdoren në të gjitha fushat e jetës njerëzore, dhe ushtria sigurisht nuk është lënë jashtë saj.

Armët moderne si tanket dhe nëndetëset janë zhvilluar të gjitha, por çfarë mund të përdorë një ushtar për mbrojtjen e tij/saj personale? Këto janë sigurisht uniformat e tyre. Kështu që sot ne do të shohim disa uniforma ushtarake më të fuqishme në mbarë botën, disa nga këto armë janë ende në zhvillim, dhe shumica janë tashmë të zhvilluara.

Uniforma ushtarake është një veshje e standardizuar e veshur nga anëtarët e forcave të armatosura dhe paraushtarakët e kombeve të ndryshme.

Veshjet dhe stilet ushtarake kanë kaluar nëpër ndryshime të rëndësishme gjatë shekujve, nga veshjet shumëngjyrëshe dhe të përpunuara, të zbukuruara deri në shekullin e 19-të, tek uniformat e kamuflazhit utilitar për qëllime fushore dhe beteje nga Lufta e Parë Botërore (1914–1918) e në vazhdim. Uniformat ushtarake në formën e veshjes së standardizuar dhe të veçantë, të destinuara për identifikim dhe ekspozim, janë zakonisht një shenjë e forcave të organizuara ushtarake të pajisura nga një autoritet qendror.

Por cilat janë uniformat më mbresëlënëse në botë?
(vijon)

5. idZ-ES

Me “IdZ-ES”, industria gjermane ka zënë një pozicion udhëheqës në sistemet moderne të ushtarëve. Ky sistem përmirëson në mënyrë dramatike aftësitë e ushtarëve të zbritur në luftime në të gjitha skenarët. Të gjitha funksionet e sistemit mund të operohen lehtësisht dhe në mënyrë intuitive edhe nën stres luftarak pa i imponuar stres



shtesë ushtarit.

Përhapja e “idZ-ES” shënon zbatimin e parë të një përqasjeje gjithëpërfshirëse të sistemeve për një sistem ushtari, në të cilin përbërësit e sistemit individual janë përshtatur me kujdes me njëri-tjetrin në mënyrë që të arrihet

performanca optimale e përgjithshme e skuadrës së këmbësorisë kur performon shumëllojshmërinë e detyrave të tij operative. Theksi u vu në uljen e peshës, miniaturizimin dhe përmirësimin e integritetit dhe modularizimit.

Rritja e efektivitetit luftarak, përmirësimi i aftësive komanduese dhe kontrolluese dhe mbijetesa në nivel skuadre ishin kriteret më të rëndësishme për zhvillimin e komponentëve kryesorë.

Zhvilluesit ushtarakë gjermanë kanë filluar zhvillimin e kostumit të tyre luftarak shumëfunksional që është shumë i ngurtë dhe i trashë ndryshe nga të tjerët, thjesht duket sikur gjermanët janë shumë më të interesuar për mbrojtjen sesa për rehatinë. Vetëm pamja e uniformës së tyre është mjaft e mirë për t’ju tmerruar. idZ-ES ka diçka unike, një sistem navigimi dhe kontrolli që mbledh informacion për pozicionin dhe vendndodhjen e një armiku aty pranë.

6. Ekzoskeleti i konturuar (Contour Exoskeleton)

Teknologjitë e ekzoskeletit mund të sjellin aftësi të reja në forcat luftarake



dhe të përmirësojnë qëndrueshmërinë dhe sigurinë në mjediset industriale. Lockheed Martin vazhdon përsosjen e produkteve industriale të gjeneratës së ardhshme me fokusin tonë kryesor në ekzoskelete me fuqi. Ekzoskeletoni i ri i



Lockheed Martin për trupin e poshtëm, ONYX, ka demonstruar aftësinë e tij për të rritur lëvizshmërinë dhe për

Uniformat ushtarake më të frikshme e mbresëlënëse në botë

të reduktuar lodhjen e përdoruesve të tij. Duke reduktuar përpjekjet në ecje dhe ngjitje, kjo teknologji fjalë për fjalë mund t’i ndihmojë ushtarët dhe reaguesit e parë të kalojnë miljen shtesë ndërsa mbajnë pajisje thelbësore për misionin.

Inxhinierët ushtarakë kinezë kanë filluar të zhvillojnë kostumin e tyre të luftës që duket njësoj si një veshje e brendshme e zakonshme, kostumi është ndërtuar në atë mënyrë që forcat e ushtarëve mund të rriten në një raport 5:1, që do të thotë se një ushtar do të jetë 5 herë më i fortë se fuqia e tij normale.

ONYX përputhet me trupin e njeriut. Sensorët e shpërndarë në ekzoskelet raportojnë shpejtësinë, drejtimin dhe këndin e lëvizjes në një kompjuter në bord që drejton aktivizuesit elektromekanikë në gjunjë. Ekskeleti jep çift rrotulluesin e duhur në kohën e duhur për të ndihmuar përkuljen dhe shtrirjen e gjurit. ONYX përfundimisht zvogëlon energjinë e nevojshme për të kaluar terrenin, për t’u ulur ose për t’u gjunjëzuar. Këto përfitime janë më të dukshme kur ngjitni ose zbrisni shkallët ose lundroni në sipërfaqe të pjerrëta.

7. Uniformë e Lehtë Sulmuese Taktike Operatori (Tactical Assault Light Operator Suit-TALOS)

Kostumi përmban një ekzoskelet me fuqi, me trup të poshtëm për të transferuar peshën deri në rripin e belit dhe e mbështet atë me aktivizues të motorizuar në secilën këmbë. Ekzoskeleti mbështet një sistem të armaturës së trupit të aftë për të ndalur fishekët e pushkës që rrethojnë 60 për qind të operatorit, krahasuar me 18 për qind me jelekët e blinduar aktual. Për të lehtësuar peshën, aktivizuesit e këmbës marrin secilën këmbë dhe e lëvizin atë ndërsa personi lëviz, dhe e zbresin peshën e helmetës, armaturës dhe jelekut përmes një shtylle të ngurtë, të

artikulluar, duke transferuar peshën nga zonat e dobëta të qafës dhe shpinës. Një paketë e vogël energjie fuqizon kostumin dhe një jelek ftohës, pompon



ujin përmes tubave prej tre metrash poshtë kostumit për të ruajtur temperaturën bazë; paketa e energjisë ka një ventilator ftohës që mund të dëgjohet në afërsi, por mendohet se nuk do të ketë rëndësi pasi të thihet një derë. “Kinetic Operations Suit” i është nënshtruar testimit të zjarrit të drejtpërdrejtë dhe skenarëve luftarakë dhe ka kryer me sukses të njëjtat detyra si operatorët e pajisur aktualisht në perioda të ngjashme kohore.





(vijon)

Ministri i Mbrojtjes uron fëmijët me rastin e 1 Qershorit

Ministri Peleshi: Unë besoj se e ardhmja do të jetë si buzëqeshja juaj e pastër



"Në Ditën e Festës tuaj, një urim të ngrohtë e të përzemërt për të gjithë ju fëmijët shqiptarë, në veçanti për fëmijët e prindërve të Forcave të Armatosura, të cilët sakrifikojnë kënaqësinë e rritjes tuaj në sytë e tyre, për të siguruar qetësinë dhe mbrojtjen e jetës. Gëzuar 1 Qershorin fëmijë! Të ecim dorë për dorë me fëmijët, për të mos u dorëzuar deri në realizimin e ëndrrave të tyre, për t'iu ruajtur buzëqeshjen e pastër e cila në fytyrat e tyre është gëzimi dhe motivimi ynë për të bërë gjithçka që ata të kenë një jetë sa më të lumtur.

Fëmijët meritojnë të drejtën të mendojnë se mund të ndryshojnë botën, dhe unë besoj fort tek ata", -u shpreh ministri Peleshi në urimin drejtuar fëmijëve në ditën e 1 Qershorit.